

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

- “Blerje kompjutera dhe Liçenca”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Pajisje elektronike – 31710000-6.

VLERA E FONDIT LIMIT:

- 8.398.843 (tetë milion e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e dyzet e tre) lekë, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor – **Autoriteti Portual Durrës** – ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas shtojcës 7, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” dhe shtojcës 8 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”.

2.2.Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit e financiare (2020, 2021 dhe 2022), ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një me vlerë jo më pak se 30 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c e 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe

të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenin 40, pika 4 e 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare me:

a) **ISO 9001 2015** ose ekuivalente (per sistemin e menaxhimit të cilësisë, te vlefshme).

Çertifikat e mesiperme duhet te jetë e vlefshme te pakten ne ditën e zhvillimit te ketij prokurimi.

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-së Nr. 285 date 19.05.2021, të ndryshuar, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certefikata ISO sipas zërave te punëve/mallrave/shërbimeve qe do te marr përsipër te realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi:

*Përmbushja e standartit **ISO 9001 2015** ose ekuivalent është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kerkohen. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.*

2.3.3 Për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE/BOE dhe për përmbushjen me sukses të kontratës, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim të dedikuar me referencen e kesaj procedure prokurimi, nga Prodhuesi / Distributori i autorizuar, për shitjen dhe shërbimin e suportit të Garancive perkatese per produktet e ofertuara, sipas tabelës së produkteve në vijim. Autorizimi i Prodhuesit / Distributorit të autorizuar të përfshijë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax, email, website. Në rast të paraqitjes së Autorizimeve të marra nga Distributori i Autorizuar respektiv të vërtetohet lidhja ndërmjet Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar.

F.V Njesi Qendrore + Monitor Tipi 1
F.V Njesi Qendrore + Monitor Tipi 2
F.V License Microsoft Office
F.V Laptop Advanced
F.V Laptop Praktik
F.V Printer per Karta
F.V Barcode Printer

Argumentimi

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu, Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, i garanton gjithashtu AK se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikëpamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë.

Duke qenë se objekt i kësaj procedure prokurimi janë pajisje dhe licenca është gjykuar të kërkohet autorizimi për produktet kryesore 1, 2, 5, 6, 7, 9, 10, të cilat janë kompjutera, laptope, printera dhe licenca Microsoft Office e cila ka një sasi të konsiderueshme prej 50 copësh.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një numër prej mesatarisht 3 (tre) punonjës të siguar, ku përfshihet një personel teknik që do të angazhohen në montimin e pajisjeve të ofertuara, si vijon:

- a) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve kompjuterike/informatike “CompTIA IT Operations Specialist”, ose ekuivalent.
- b) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve të rrjetit “CompTIA Network Infrastructure Professional”, ose ekuivalent.
- c) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar nga prodhuesi për instalimin e programeve Office që do të ofertohen nga operatori ekonomik, ose ekuivalent.

Një punonjës mund të disponojë më shumë se një certifikatë.

Për të vërtetuar stafin e mësipërm, operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Deklaratë për stafin përgjegjës
- Certifikata përkatëse/ Transkriptet përkatëse
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig. 025/a për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi.

Kërkesat e mësipërme duhet të vërtetohen me: Certifikatat /Transkriptet përkatëse.

Argumentimi

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

1. *Për kriterin në pikën a), duke qenë se objekt i procedurës së prokurimit është furnizimi dhe vendosja e pajisjeve kompjuterike të tipit Kompjuter, Monitor, Printer, Laptop, është gjykuar e nevojshme që Operatori Ekonomik të ketë në stafin e tij të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel teknik pajisjesh kompjuterike “CompTIA IT Operations Specialist”. për të siguruar instalimin e saktë të pajisjeve. Gjithashtu ky certifikim siguron edhe suportin gjatë periudhës së garancisë. Zgjedhje për këtë certifikim vjen pasi ai nuk lidhet me asnjë brand pasi është Vendor Neutral dhe ofron garanci që specialistët e certifikuar do të mund të realizojnë punën e kërkuar.*
2. *Për kriterin në pikën b), duke qenë se pajisjet objekt i procedurës së prokurimit do të instalohen, konfigurohen dhe punojnë në rrjetin kompjuterik të institucionit, është gjykuar e nevojshme që Operatori Ekonomik të ketë në stafin e tij të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel teknik pajisjesh kompjuterike “CompTIA Network Infrastructure Professional” për të garantuar konfigurim të saktë dhe për të siguruar suport gjatë kohëzgjatjes së garancisë. Zgjedhje për këtë certifikim vjen pasi ai nuk lidhet me asnjë brand pasi është Vendor Neutral dhe ofron garanci që specialistët e certifikuar do të mund të realizojnë punën e kërkuar.*
3. *Për kriterin në pikën e) duke qenë se software objekt i procedurës së prokurimit janë 50 licensa Microsoft Office, është gjykuar që operatori ekonomik të ketë në stafin e tij të paktën 1 (një)*

specialist të certifikuar nga prodhuesi për instalimin e programeve Office. Kjo do të garantonte instalim të saktë të softuerit dhe mirëmbajtje gjatë gjithë periudhës së liçensimit.

2.3.5 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin Dokumentin e titulluar Ofertë Teknike të ngarkuar në SPE nga Autoriteti Kontraktor në formën e një tablele kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi artikujt e Listës. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

- a) Emri i kompanisë prodhuese ose distributori i autorizuar nga prodhuesi me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në dokumentat e ofertimit. Adresa dhe web-siti të sakta të kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar.
- b) Emërtimi i Katalogut të prodhuesit.
- c) Nr. i faqes në katalog referuar Nr. Identifikues të artikullit të ofruar sipas listës i shënuar me një shenjë dalluese.

Afati i lëvrimit të produkteve/shërbimit do të jetë 30 (tridhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë duke qenë të paanshme, lidhur me kërkesat e Autoritetit Kontraktor për furnizimin me pajisjet elektronike duke u mbështetur në standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke pasur parasysh garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në përcaktimin e specifikimeve teknike për paisjet Kompjuter, Laptop dhe projektor janë vendosur parametra teknike sipas standarteve të përcaktuara nga AKSHI, ndërsa specifikimet teknike të paisjeve aksesorëve të tjerë elektronike janë vendosur në përputhje me modelin e paisjes që disponon AK, të cilat janë të përshtatshme dhe të domosdoshme për funksionin e paisjeve lidhur me përdorimin dhe funksionalitetin e tyre.

Për sa më sipër, specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emri të veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ka ekzistuar një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, dhe është cituar fjala “ose ekuivalent” e përfshirë detyrimisht në këto specifikime.